

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE KOMPJUTERIKE

PROFILI AKADEMIK

Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike(DSHAK) ka si qëllim promovimin dhe zhvillimin e njohurive në shkencat e aplikuara dhe kompjuterike. Synon të edukojë studentët për të qenë të suksesshëm, etikë, dhe efektivë në zgjidhjen e sfidave të ndryshme, duke i përgatitur ata për të kontribuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike të vendit dhe rajonit. Departamenti ofron programe dhe kurse konkurruese, që i mësojnë studentët se si të përdorin teknologjitë e reja në mënyrë kreative dhe efektive, duke promovuar eksperimentimin dhe zhvillimin e njohurive të reja.

Studentët mund të nisin një udhëtim drejt suksesit në karrierë në një shumëllojshmëri fushash, përfshirë mundësi punësimi në:

- Zhvillues Softueri: Punë si zhvillues aplikacionesh ose inxhinierë softueri për kompani të ndryshme.
- Analizë e Sistemeve: Shqyrtim, projektim, dhe implementim i sistemeve të informacionit në organizata.
- Siguria Kompjuterike: Mbrojtja e të dhënave dhe sistemeve nga rreziqet e sigurisë kompjuterike.
- Inxhinieri i Rrjetit: Menaxhimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve kompjuterike të organizatave.
- Analist i të Dhënave: Analiza e të dhënave për të marrë vendime të informuara.
- Zhvillues i Lojërave Video: Punë në industrinë e zhvillimit të lojërave video.

VIZIONI

Të transformojë mënyrën si teknologjia përdoret për të adresuar sfidat e shekullit të 21. Përmes edukimit cilësor, kërkimit të avancuar dhe përfshirjes në komunitet, të jemi katalizatorë për ndryshime transformuese. Të shfrytëzojë potencialin e teknologjisë për përmirësim të jetës së njerëzve dhe të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë në tërësi.

MISIONI

Të krijojë dhe zbatojë njohuritë në shkencat e aplikuara dhe kompjuterike, duke përfshirë edhe fushat ndërdisiplinore që janë me përfitim për shoqërinë dhe biznesin; për të edukuar studentët të kontribuojnë pozitivisht në mirëqenien ekonomike të vendit tone dhe rajonit për të trajtuar sfidat komplekse të shekullit të ri.

STRATEGJIA ZHVILLIMORE

Departamenti ka ndërtuar një rrjet të fortë partneriteti me institucione publike dhe private, duke ofruar trajnime praktike dhe duke ndihmuar në integrimin e studentëve në tregun e punës. Veprimtaria e tij përfshin leksionet, përfshirjen në klube studentore dhe programet e trajnimit të specializuara si edhe pjesëmarrja aktive në projekte kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e shkencave të aplikuara dhe IT.

PROFILI R&D¹

Fusha e gjerë e veprimtarisë² R&D e DSHAK përfshin:

1. INXHINIERIA DHE TEKNOLOGJIA

- Inxhinieri civile
- ***Inxhinieri elektrike, elektronike dhe informatike***
- Inxhinieri mekanike
- Inxhinieri e materialeve
- Bioteknologji industriale
- Nanoteknologji

2. SHKENCAT NATYRORE

- Matematikë
- ***Shkenca kompjuterike dhe informacioni***
- Fizikë
- Kimi
- Shkencat e Tokës dhe mjedisit
- Shkencat biologjike

Dhe konkretisht :

- **Teknologjia e Informacionit (TI)**
- **Shkencat Kompjuterike & Siguria Kibernetike**
- **Shkenca e të Dhënave, Analitika & Big Data**
- **Teknologjitë Web & Cloud Computing**
- **Inteligjenca Artificiale & Të Mësuarit e Makinës (Machine Learning)**
- **Elektronika & Teknologjia Embedded**

¹R&D ->Research and Development (Kërkim-Zhvillimi)

² Sipas manualit të Fraskatit

- **Mekatronika & Robotika**
- **Sistemet e Informacionit & Inxhinieria e Softuerit.**